

REPUBLIKË E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	90/24
Nr. i fq. / Br. st.	-4-
Data: / Datum:	17.05.2024
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

### PROCESVERBAL

**në mbledhja e IV-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 prill 2024  
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Agron Perçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtoret e drejtoreve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se në mbledhjen e kaluar është dashur të vjen raporti i ndërmarrjes "Përparimi", nuk ka ardhur as në këtë mbledhje. Nuk e di se a po e dinë ata që nuk janë të përgjegjshëm. Prandaj, kam kërkuar edhe një herë, do të kërkoj prapë që në seancën e Kuvendit të shkarkohet komisioni i aksionarëve.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se edhe ne kemi bërë përpjekje ta kemi atë raport, na kanë thënë që ka gjasa me u përgatitë për seancë, të shohim nëse do e sjellin. Këto janë informatat qysh na i kanë kthy, nuk kemi informata tjera.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – kërkoi që raporti mos të vjen ditën e seancës, sepse nëse vjen atë ditë në mbledhje, unë personalisht nuk e pranoj edhe do t'i jap vërejtjet e mia aq sa mundëm, se e kemi mësuar lojën e tyre. E sjellin ditën e fundit të seancës ose në seancë, për arsy me pasë mundësi ta shpalosim materialin, t'i gjejmë të gjeturat që kanë, gabimet e keqpërdorimet e gjithë ato çka po ndodh në ndërmarrje. Për këtë arsy, ti si kryesuese mos e prano materialin nëse të vjen jashtë rendit të ditës.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – rendi i ditës dorëzohet sot, por nëse ju pajtoheni që nëse na e sjellin materialin një ditë ose dy para seancës ta pranojmë, por jo ditën ditën e fundit për shkak se na duhet kohë për ta shfletuar materialin.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se atë që e ngriti Agroni, desha ta ngris edhe unë. Ndërmarrja "Përparimi" në mbledhjen e kaluar e solli një arsyetim të thjeshtë, kurse tash as atë arsyetim të thjeshtë nuk e kanë dërguar se pse nuk e kanë sjell reportin. Po ashtu i kemi me plan të punës edhe rapportet e K.R.U "Mitrovica" dhe K.R.M "Uniteti", të cilat nuk janë dërguar. Të tri këto raporte janë në interes të qytetarëve që ne si kuvend t'i diskutojmë. Tek ndërmarrja "Përpraimi", e dimë se çfarë zhvillimesh ka aty, keqpërdorime të natyrave të ndryshme po ndodhin në atë ndërmarrje. Po i shohim çdo ditë zyrtarët, të cilët i marrin veturat zyrtare nëpër shtëpi, i mbajnë natën aty, kurse, ditën udhëtojnë me to,

po ashtu dalin vikendeve shëtitën me vetura zyrtare. Prandaj, veturat janë të paregjistruara dhe dalin në qarkullim. Janë blerë makineri të rënda dhe me çmime shumë të fryera nga kompanitë e luleve, që nuk e e kanë biznes primar, shitjen e veturave e kështu me radhë.

Për shkak se ne jemi duke ngecur me zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit, si dhe akoma po vazhdojmë të kemi redukttime në pjesë të caktuara të Komunës së Vushtrrisë, është shumë me interes ta kemi edhe raportin e K.R.U “Mitrovica”. Po ashtu, duhet ta kemi edhe raportin e K.R.M “Uniteti”, megjithëse tashmë i kanë kufizuar aktivitetet, për shkak të kalimit të menaxhimit të mbeturinave, grumbullimit të tyre nga “Përparimi”. Megjithatë, duhet ta shohim situatën se çfarë ka ngelë nga shërbimet tek kjo kompani, cila është gjendja në këtë ndërmarrje dhe cili është fati i aksioneve të komunës aty.

E shpreh shqetësimin dhe mospajtimin tim të plotë me mosardhjen e këtyre raporteve të të tri kompanive dhe se është e patolerueshme një papërgjegjësi e tillë dhe një mospërfillje e kuvendit komunal.

Prandaj, edhe ju si kryesuese duhet tashmë t'i keni disa e-maila të deponuara në drejtim të menaxhmenteve dhe përgjegjësve që t'i dorëzojnë këto raporte për t'i njoftu që veprimet e tillë janë të papranueshme. E derisa nuk kemi asnjë dëshmi të tillë deri në seancë, të paktën t'i kemi dëshmi që ju si kryesuese e Kuvendit, keni avoku për me mbrojtë interesin qytetar dhe mbi të gjitha planin e punës së Kuvendit.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se në shkresën që e keni marrë edhe ju në adresat tuaja elektronike për K.R.U “Mitrovica” dhe K.R.M “Uniteti”, nuk kemi ndonjë afat, të cilin e kanë përcaktuar ata për t'i dorëzuar raportet. Nëse jeni dakord si Komitet për Politikë e Financa, e kishim caktuar vetë muajin maj si mundësi për t'ju thënë që t'i sjellin. Nëse nuk e sjellin në maj, të na jadin arsyetim me shkrim, jo sikur ndodhi deri tanë.

#### **Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

#### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.03.2024
  2. Shqyrtimi i Raportit tremujor të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2024
  3. Shqyrtimi i Draft – Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë 2024-2026
  4. Pyetje dhe përgjigje.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.03.2024.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, aprovoi procesverbalin e datës 15.03.2024.**

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – pyeti se a janë marrë mjete nga përmbaruesit gjatë këtij viti në këtë tremujor, nga Komuna e Vushtrrisë lidhur me obligimet që i dalin komunës nga kontratat për arsim? Pse disa rasteve të caktuara të mësimdhënësve nuk iu kanë ekzekutuar mjetet? Cila është arsyaja? Kjo duket të jetë diskriminuese, kur një pjese

të mësimdhënësve mos me ju ekzekutuar injetet. Nëse ka tendencë për këtë çështje, kush është përgjegjës për veprime të tilla?

A mund të na e siguroni një informatë deri në kuvend: Sa mjete janë shpenzuar për dreka edhe iftare në tremujorin e parë të këtij viti?

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – kërkoi disa sqarime lidhur me shpenzimet. Ajo tha se vitin e kaluar në disa tabela janë dukshëm më pak shpenzimet, ndërsa në këtë vit, për shembull, tek shpenzimet e vogla (para xhepi) janë 1,129.00€. Po ashtu, shërbime të avokaturës, a është kjo pagesa për përmbaruesit, për avokatët, për çështjen e shujtave apo diçka tjeter, shërbime kontratuuese tjera?

A hyjnë këtu kontratat me shërbime të veçanta, apo çka është kjo shumë kaq e madhe?

Edhe furnizim për zyrë, kjo shumë prej 15,944.77€.

Tek drutë, a keni blerë drunj në periudhën shkurt - mars, në vlerë 115,699.00€? S'e di a janë blerë drutë më herët apo këtë vit?

Edhe mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve, po më duket një shumë e madhe, 12,613.99€. Për çfarë pajisjesh është fjala?

Subvencionet për entitetet publike (12,300.00€) dhe jo publike (156,293.00€), a ka mundësi me na e sqaru?

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se ndërtimi i kanalizimit Akrashticë-Balincë (kodi 53231), buxheti 29,210.00€, shpenzimi për periudhën 25,000.00€, mjete të lira 4,210€, a ka mundësi me na e sqaru, sepse këtu nuk kam parë kurrfarë investimi, kurse paratë janë harxhuar. A i ka marrë këto mjete përmbaruesi e ka mbetur projektii pa u realizuar dhe se pse bash në këtë vend kur gjendja është shumë e keqe me kanalizim?

Tek projektet për investime kapitale në shëndetësi, po e shoh që kanë ndryshuar titujt e projekteve nga ajo që e kemi votuar buxhetin. Kush mban përgjegjësi për këtë çështje? Ju kam paralajmëruar me kohë atëherë që jeni duke votuar diçka gabim në buxhet dhe "copy-paste" nga viti paraprak. Por, ju insistonit që ta votoni buxhetin, e më vonë i keni ndryshuar titujt e projekteve. Prandaj, personat që e kanë prekur buxhetit (pasi që është miratuar nga kuvendi), sigurisht që do të ndiqen ë sipas ligjeve në fuqi, sepse përbën një akt të rëndë të shkeljes ligjore, ndryshimi i buxhetit pasi që është miratuar dhe jashtë procedurave të kuvendit.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**– tha se raporti tremujor i shpenzimeve për periudhën janar-mars 2024 bazohet në planin e punës të vitit 2024, konform planit të rrjedhjes së parasë. Kështu që, ne për këtë tremujor jemi të obliguar edhe me plan të punës të prezantojmë reportin tremujor. Mirëpo ky raport është me gjendje faktike, ashtu si ka qenë i planifikuar, alokuar, i zotuar dhe i shpenzuar. Ai tha se s'po ju marrë kohë shumë, por po u përgjigj pyetjeve të parashtruara.

Lidhur me çështjen e përmbaruesve, Jashari tha se mbi një milion e treqind mijë euro këtë vit na i kanë marrë për inflacion te punëtorët e arsimit. Kërkosën të cilën e kemi dorëzuar ne, iu kemi sugjeruar që mjetet të merren nga disa zëra buxhetorë. Ka pasur raste në të kaluarën kur Departamenti i Thesarit shumë herë na ka pyetur neve ku me ua marrë mjetet që mos me ua prish planin, Por, këtë herë, Ministria e Financave - Departamenti i Thesarit, kanë bërë vetë alokim të parakohshëm nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve në Drejtorinë e Arsimit dhe një milion e treqind mijë euro janë shpenzu për qëllimet tyre, me qëllim që në fundvit të bëhet transferi, aty ku ka mjete të lira, të merren apo të mbulohet nga ana e tyre.

Sa i përket disa mësimdhënësve (që janë shumë prej tyre), që ende nuk e kanë gëzuar këtë të drejtë, për shkak se ka pasur pagesa të dyfishta dhe është dashur të informohen

mësimdhënësit që janë ardhë prej përmbaruesve, t'i kthejnë mjetet dhe derisa janë verifikuar listat, nuk i kam proceduar. Por, shpresoj që në një të ardhme të afërm, edhe këta mësimdhënës do i gjithë tjerët.

Lidhur me mjetet, të cilat janë shpenzuar për dreka dhe iftare, do ju informojë në mbledhjen e ardhshme.

Lidhur me pyetjet për pagesat e parave të imëta, vendimeve të gjykatave, blerjen e drunjëve, mirëmbajtjen e pajisjeve të subvencioneve, ai sqaroi se muaji janar, shkurt, të gjitha faturat, të cilat kanë ardhë në muajin dhjetor, nuk kanë mundur të shpenzohen. Domethënë, përpos mjeteve të cilat i kemi pasur të planifikuara për shpenzim këtë tremujorësh, i kemi pasur edhe obligimet e viteve të kaluara, të cilat barten këtë vit dhe shuma është trefishuar apo katërfishuar në disa pozicione, për shkak të obligimeve të cilat i kemi. Mirëpo, gjithçka ka qenë në bazë të planit të paraparë dhe në bazë të mjeteve të planifikuara buxhetore.

Sa u përket subvencioneve, janë marrë disa vendime në këtë Kuvend për shërim të entiteteve publike dhe jopublike, të cilat i kemi paguar. Por, u kemi dhënë prioritet obligimeve të papaguara.

Në këtë vit, mjetet të cilat i kemi pasur të planifikuara, në bazë të kërkesave nga drejtorët e drejtorëve, dhe në bazë të planifikimit të buxhetit është bërë edhe realizimi i pagesave (bilancet e paspenzuara këtë tremujorësh barten në tremujorëshin e dytë). Kuptohet që shumat janë bukur të mëdha, por të parapara me plan buxhetor të gjitha.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – tha se sa i përket kolektorit Akrashticë - Balincë, është prej rrugës “Ragip Shala” deri në fund të fshatit Balincë. Ai tha se është punuar vitin e kaluar diku deri te lagja “Mehana”, sivjet gjatë muajit mars ka vazhduar dhe ka përfunduar në Balincë.

Kurse, sa i përket kanalizimit, është shqetësim edhe për mua, por atë me kontratë të mirëmbajtjes dhe riparimit kemi me përfunduar me

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Draft – Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë 2024-2026.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe KPF- së